REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Maliq më 25 .06.2025

3201

Projekt-Vendim – Nr. 5

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nën pika 1.1, gërma "b",ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të kërkesave të bëra nga familjet e mëposhtme dhe verifikimeve të bëra nga punonjesit socialë të Bashkisë Maliq për gjëndjen social-ekonomike për familjet e mëposhtme i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

I. Miratim fondi për familjet e mëposhtëme:

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma /Lekë
1	Shide Qemal Rexho	F65304150W	Maliq	20000
2	Nazike Zenel Çelanji	G45222191J	Libonik	20000
3	Gjergji Ylli Gozhdari	H30518047P	Gorë	20000
4	Roland Sadik Elmasllari	H91127017M	Gorë	30000
5	Aurora Çlirim Metko	I75219028U	Libonik	30000
6	Hektor Shyqyri Metani	F31118098A	Maliq	20000
7	Endi Kujtim Braçellari	J90830019S	Libonik	30000
8	Mimoza Mihallaq Panajoti	G45214249B	Maliq	10000
9	Idajete Ibrahim Çaçi	G15813119H	Maliq	10000
10	Bejo Shyqyri Llapanji	G20126028M	Libonik	10000
11	Maria Hasim Orani	E95215198H	Maliq	20000
12	Xhezmi Fadil Beqiraj	G20920043D	Vreshtas	20000
13	Silvana Avni Qorllari	H55515048U	Vreshtas	20000
14	Yllson Karafil Zaçellari	H10730091U	Pirg	30000
				290000

II. Fondet do të përballohen nga Buxheti i vitit 2025, si më poshtë :

Gr.	kap	Kod. Prog.	Llog.eko	Emert.Llogarise	Vlera në lekë
00	05	01110	606	Fondi Social	290 000

III. Bashkëngjitur projekt-vendimit relacionin me gjëndjen Social–Ekonomike të familjes.

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

Konceptoi Pergj Sek I Shërbimeve Sociale
Miratoi:Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

3701

Maliq më 25.06.2025

Relacion

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare për familjet në nevojë"

Në mbështetje të ligjit nr .139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",ligji nr 9936,datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". Në bazë të verifikimeve të bëra nga punonjësit e Ndihmës Ekonomike Maliq, të Njësive të Bashkisë Maliq për gjendjen social-ekonomike të familjeve të mëposhtme rezultoi se

1. **Shide Rexho**

Familja e Z.Shide Rexho përbëhet nga 5 anëtarë, jeton në Qytetin Maliq ,Bashkia Maliq. Familja ndodhet në kushte të vështira social-ekonomike ndërsa banesa ku jetojnë është në gjëndje të amortizuar. Të ardhurat e vetme të familjes vijnë nga ndihma ekonomike e djalit dhe pensioni i saj. Bashkëshorti i saj, Z. Major, ka ndërruar jetë pasi vuante nga një sëmundje e rëndë kronike (Hemipleji e djathtë), duke e lënë familjen me vështirësi të mëdha financiare. Znj. Shide është e moshuar dhe ka pasur shpenzime të mëdha për përballimin e trajtimeve shëndetësore të bashkëshortit të ndjerë. Përveç kësaj, në të njëjtën banesë jeton edhe nipi i saj, Antonio Rexho, i cili është person me aftësi të kufizuara dhe i diagnostikuar me prapambetje mendore të moderuar dhe me Sindromën e Surodumit-çm.Për shkak të situatës së rëndë shëndetësore dhe mungesës së të ardhurave të mjaftueshme, familja gjendet në pamundësi për të përballuar shpenzimet e nevojshme për jetesë, përkujdesje dhe shërbime. Rrjedhimisht, kërkohet që Këshilli Bashkiak i Maliqit të miratojë një mbështetje financiare për këtë familje në nevojë.

2. **Nazike Celanji**

Familja e znj. Nazike Celanji përbëhet nga 6 anëtarë dhe banon në fshatin Drithas, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Familja ndodhet në kushte të vështira jetese dhe përballet me probleme të shumta sociale dhe shëndetësore.Njëri prej anëtarëve të familjes, djali i saj, vuan nga një sëmundje mendore e rëndë dhe është i diagnostikuar me Skizofren gjithashtu edhe vajza vuan nga probleme të shëndetit mendor me diagnozë malformime e SNQ me dëmtime të zhvillimit psikomotroe të mesëm në të rëndë, është e divorcuar me nje fëmijë i cili gjithashtu vuan nga sëmundja me diagnozë prapambetje mendore e shkallës së mesmë , me çrregullime psikiatrike ICD-10, DSMIV.Familja është ndihmuar herë pas here me paketa ushqimore duke u përfshirë në projektin shërbimi në familje gjithashtu trajtohen me ndihme ekonomike, kryefamiljari është në pension dhe 3 anëtarët e mësipër marrin pagesë të aftësisë së kufizuar. Për shkak të dëmtimeve që kanë është i nevojshëm marrja e mjekimeve mujore të cilat rëndojnë ekonominë e familjes. Nga vizita në familje kushtet e banimit janë të papërshtatshme për të

jetuar dhe familja nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën. Në këto kushte kërkon nga Këshilli Bashkiak Maliq një ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve.

3. Gjergji Gozhdari

Familja e zotit Gjergji Gozhdari jeton në fshatin Lozhan Njësia Adminitrative Gorë. Familja përbëhet nga 6 antarë. Të ardhurat e vetme të familjes sigurohen nga paga e babait. Djali i vogël i familjes vuan nga sëmundja Surdomudizëm Kongentinal si dhe prapambetje mendore, gjithashtu prej një viti është frekuentues i Qendrës Komunitare Maliq mbas vendosjes së aparatit të dëgjimit, për shkak të diagnozave që ka duhet të marrë terapi të të folurit dhe zhvillimore të cilat janë terapi të kushtueshme duke marrë edhe parasysh distancën që ka kjo familje nga adresa e banimit tek ofruesit e ketyre shërbimeve, në këto kushte kërkon nga Këshilli Bashkiak Maliq një ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve.

4. Roland Elmasllari

Nga vizita e kryer në familjen e Z. Roland Elmasllari rezulton se ai jeton me dy fëmijët dhe bashkëshorten e tij në fshatin Lozhan Njësia Adminitrative Gorë. Të ardhurat e vetme të familjes sigurohen nga pagesa e ndihmës ekonomike. Vajza e vogël e familjes vuan nga Çrregullim i spektrit Autik, si dhe prapambetje mendore, gjithashtu prej disa kohësh është frekuentues i Qendrës Komunitare Maliq për shkak të diagnozave që ka duhet të marrë terapi zhvillimi të cilat janë terapi të kushtueshme duke marrë parasysh distancën që ka kjo familje nga adresa e banimit tek ofruesit e ketyre shërbimeve, ndodhur në këto kushte kërkon nga Këshilli Bashkiak Maliq një ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve.

5. Aurora Metko

Familja e Znj.Aurora Metko përbëhet nga 5 antarë, ata jetojnë në Njësinë Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Familja jeton në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore. Vajza e Aurores (Mei Metko) 3(tre) vjeç vuan nga një sëmundje e rëndë, me diagnozë *Encefalopati epileptogjene, Sindrom Autozomal Recesiv Joubert tipi 17. X-linked Rett Sindrome.* Që në vitin e parë të jetës, fëmija ka shfaqur kriza konvulsive, vonesë në zhvillimin motorik dhe mungesë të aftësive bazë si ecja dhe belbëzimi. Ajo nuk flet, nuk ecën dhe nuk reagon në mënyrë të përshtatshme për moshën.Fëmija ka nevojë për një sërë analizash mjekësore dhe ndjekje të vazhdueshme terapike, për të cilat mjekët kanë rekomanduar ndërhyrje urgjente. Kostoja e trajtimeve mjekësore është shumë e lartë dhe për shkak të kushteve ekonomike të vështira, familja nuk është në gjendje të përballojë këto shpenzime.Gjithashtu zonja Aurora ka dhe dy fëmijë të tjerë të cilët shkojnë në shkollë dhe kanë shpenzime ditore dhe mujore, ndodhur në këto kushte kërkon nga Këshilli Bashkiak Maliq një ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve.

6. Hektor Metani

Z.Hektor Metani është banor i Qytetit Maliq , familja e tij përbëhet nga 2 antarë , ai jeton me bashkëshorten e cila ka probleme të shëndetit dhe aktualisht ka nevojë për një ndërhyrje pasi ka pasur komplikacione për shkak të sëmundjes Cancer I Colonit dhe hipertensio arterial. Sipas të dhënave, familja përballet me vështirësi të mëdha ekonomike. Të ardhurat e vetme të familjes

përbëhen nga një pension i ulët, i cili nuk mjafton për të përballuar shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe jetesës së përditshme. Për më tepër, Hektori kujdeset edhe për vajzën e tij, e cila është e pa punë dhe mbesën e vogël 5-vjeç e cila kohët e fundit është diagnostifikuar me CA- në gishtin e dorës, ndodhur në kushte të vështira ekonomike dhe shëndetësore zoti Hektor i është drejtuar Këshilli Bashkiak Maliq për një ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve.

7. Endi Braçellari

Z.Endi Braçellari banon ne fshatin Libonik, të Njësisë Administrative Libonik, Bashkia Maliq.Endi është 23 vjeç dhe vuan nga një sëmundje e rrallë e cila i ka prekur gjithë shtyllën kurrizore. Ai ka kryer shumë operacione të cilat kanë kushtuar, mbas egzaminimeve të kryera jashtë vendit ai ka nevojë për një operacion tjetër i cili nuk realizohet në Shqipëri, dhe ka një kosto të lartë. Një pjesë e shumës për operacionin është mbledhur nga donatorë të ndryshëm. Duke marrë shkas nga gjendja e vështirë në të cilën ndodhet familja Shërbimi Social i Bashkisë Maliq kërkon një ndihmë financiare nga Këshilli Bashkiak, që ti bashkohemi nismës për ti ardhur në ndihmë Endit i cili ka nevojë.

8. Mimoza Panajoti

Znj.Mimoza Panajoti jeton e vetme ne qytetin e Maliqit . Është në vështirësi ekonomike dhe shëndetësore . Mimoza ka probleme me shëndetin dhe duhet të kryejë nje operacion pasi gjëndja e saj po rëndohet çdo ditë. Familja ska të ardhura, e vetmja e ardhur është ndihma ekonomike e cila nuk mjafton për përballimin e operacionit. Në këto kushte kërkon nga bashkia Maliq një ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet.

9. Idajete Çaçi

Familje e Znj.Idajete Çaçi jeton në qytetin Maliq, të Njësisë Administrative Maliq, Bashkia Maliq është e përbërë prej 2 (dy) anëtarësh. Familja ndodhet në kushte shumë të vështira ekonomike dhe shëndetësore, ku e vetmja e ardhur është ndihma ekonomike në masën 3366 lekë. Në këto kushte kërkon nga Bashkia Maliq një ndihmë financiare për të përballuar gjendjen në të cilën ndodhet famija.

10. Bejo Llapanji

Familja e zotit Bejo Lapanji është banor I fshatit Libonik në Njësinë Administrative Libonik. Familja është e perbere prej 4 antarë dhe ndodhen ne veshtiresi ekonomike dhe shendetesore. Një nga djemtë e familjes trajtohet me kemp konkretisht Anxhelino Llapanji është diagnostifikuar me Çregullim Psikotikmi Paspecifikuar gjetiu, Aksident vaskulare cerebrale dhe Çrregullime Afektive Bipolare dhe ka nevojë për kujdestar here pas here. Gjendja ekonomike është shumë e rënduar pasi nuk ka asnjë të ardhur sepse në familje nuk ka asnjë të punesuar edhe banesa është në gjëndje mjaft të amortizuar.Familja kerkon ndihme nga Bashkia Maliq për të bërë riparimet e nevojeshme.

11. Maria Orani.

Familja e Znj. Maria Hasim Orani përbëhet nga dy anëtarë,jeton në Maliq, Bashkia Maliq. Familja ka kushte të vështira social-ekonomike dhe shëndetësore. Familja përbëhet nga dy anëtarë nga zonja Maria dhe i biri Kastriot Orani.Znj Maria është në moshë pensioni dhe vuan nga probleme shëndetësore kurse djali i saj trajtohet me pagesë të aftësisë së kufizuar me diagnose *Paraliza Cerebrale Spastike Infatile* dhe *Demtime te funksioneve trupore*.Ai trajtohet me medikamente të perhershme dhe nuk është i aftë për tu kujdesur për veten. E vetmja e ardhur e familjes është pensioni i zonjes Maria, i cili eshte i ulët dhe nuk mbulon as nevojat minimale për ushqime, medikamente etj. Familja shpesh here është mbështetur nga Shërbimi Social me paketa ushqimore dhe kite-higjenike.Megjithatë për shkak të situatës së vazhdueshme të renduar,kjo familje ka nevojë për një mbështetje të vazhdueshme për të garantuar permbushjen e nevojave.

12. Xhezmi Beqiraj

Familja e zotit Xhezmi Beqiraj banon në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq. Kjo familje përbëhet nga dy anëtarë: kryefamiljari Z. Xhezmi Beqiraj dhe bashkëshortja e tij. Ata jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale.Z. Xhezmi ndodhet në gjendje të rënduar shëndetësore, pasi prej disa vitesh vuan nga disa sëmundje kronike. Ai përfiton ndihmë ekonomike për paaftësi nga Bashkia Maliq. Të ardhurat e vetme të familjes janë ato që vijnë nga kjo ndihmë sociale në kushtet aktuale, kjo familje ka nevojë për mbështetje të mëtejshme institucionale dhe vlerësim për përfshirje në programe sociale ose ndihma të tjera specifike.Zoti Xhezmi i është drejtuar Këshilli Bashkiak Maliq për një ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve.

13. Silvana Qorllari

Familja e Znj. Silvana Qorllari jeton në fshatin Podgorie, Njësia Administrative Vreshtas. Kjo familje përbëhet nga tre antarë, kryefamiljari bashkëshortja dhe djali, i cili sapo është kthyer nga emigracioni. Znj. Silvana vuan prej një kohe të gjatë nga një sëmundje e rëndë (tumorale) dhe ndodhet në trajtim të vazhdueshëm ajo udhëton rregullisht drejt Tiranës për të kryer kimioterapi, çka shoqërohet me kosto të larta për transport, medikamente dhe ndihmë mjekësore. Të ardhurat mujore të familjes janë shumë të ulëta dhe nuk mjaftojnë për të mbuluar kostot e jetesës dhe trajtimit mjekësor të saj. Ndodhur në kushte shumë të vështira social-ekonomike zonja Silvana kërkon nga Këshilli Bashkiak Maliq një ndihmë financiare për përballimin e shpenzimeve.

14. Yllson Zaçellari.

Zoti Yllson Zaçellari jeton në fshatin Pirg Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq, familja e tij përbëhet nga 2 anëtarë ai dhe bashkëshortja. Familja Zaçellari ka pasur një fatkeqësi pasi djali i tyre vetëm 20-vjeç ka ndëruar jetë nga një sëmundje e rëndë. Zoti Yllson ka shpenzuar shumë për kurimin e djalit të ndjerë si në Shqipëri ashtu edhe në shtetin Italian, djali i Yllsonit ka

ndëruar jetë në Itali dhe më pas trupi i të ndjerit është transportuar për në Shqipëri. Zoti Yllson ka shpenzuar shumë lek për kurimin e djalit dhe është në kushte shumë të vështira ekonomike në këtë situate për fatkeqësinë e tij i është drejtuar Këshillit Bashkiak Maliq për një ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet.

Konceptoi Pergj.Sek I Shërbimeve Sociale
Miratoi Dr. Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë

(Emër Mbiemër)
J.Hoxha
E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu